



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 171, Datë 28.06.2022**

**MBI**

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT  
QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “M.T.C  
ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, nenit 7 dhe nenit 9, pikat 4 dhe 5, dhe 8, si dhe nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/6 prot., datë 23.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë M.T.C ENERGY sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “M.T.C ENERGY” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 20, datë 21.03.2014, për një afat 30-vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 646 prot., datë 06.05.2022, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, nëpërmjet shitjes së 80% të kuotave të zotëruara nga “RADOVE ENERGY CAPITAL LTD”, tek “Hydrogy Holdings Single Member” S.A.
- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezultoi se dokumentacioni nuk ishte i plotë dhe po ashtu kishte nevojë për të sqaruar më tej një pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi, ndaj në datën 07.06.2022, u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë, në vijim të së cilës, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 646/5 prot., datë 07.06.2022, shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “M.T.C ENERGY” sh.p.k. rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për

*procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.*

- Shoqëria “M.T.C ENERGY” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Në vijim të dhënies së autorizimit, në zbatim të pikës 8 të nenit 9 të Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i këtij transferimi në të.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k.
2. Ortaku kryesor i shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k., me 80% të kuotave të kapitalit, bëhet shoqëria “Hydrogy Holdings Single Member” S.A.
3. Shoqëria “M.T.C ENERGY” sh.p.k. të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i këtij transferimi në të.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**